




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI



## URDHËR

Nr. 98, datë 20.6.2024

### PËR

### NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR PËR AJËR TË PASTËR (KKAP)

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr.162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit,

### URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit Kombëtar për Ajër të Pastër (KKAP) për të mundësuar bashkëpunimin ndërinstucional, i cili siguron zbatimin e koordinuar të legjislacionit dhe hartimin e zbatimit të politikave/programeve kombëtare në lidhje me pakësimin e shkarkimeve dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.
2. Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër të funksionojë si një forum këshillimor për koordinimin e politikave dhe vendimmarrjen, shkëmbimin e informacionit dhe kontrollin e përbashkët për cilësinë e ajrit, pa mandat për vendimmarrje të detyrueshme.
3. Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër të kryesohet nga zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe në përbërje të ketë anëtarë, përfaqësues nga:
  - a) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
  - b) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
  - c) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- ç) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- d) Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
- dh) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- e) Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- ë) Instituti i Shëndetit Publik;
- f) INSTAT-i;
- g) Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore;
- gj) Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;
- h) Shoqëria civile;
- i) Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

4. Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër të ketë këto përgjegjësi:

- a) Të realizojë mbikëqyrjen dhe koordinimin e përgjegjësive të institucioneve përgjegjëse, të përfaqësuara nga anëtarët e Komisionit, për masat e marra për reduktimin e ndotësve në ajrin e mjedisit nga sektorët kryesorë kontribues të ndotjes së ajrit, si transporti, industria, bujqësia, përdorimi shtëpiak i produkteve etj.
- b) Të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse për çështjet e cilësisë e të ndotjes së ajrit në hartimin e politikave/programeve kombëtare, me qëllim reduktimin e rrezikut të efekteve më serioze në shëndet të lidhura me ndotjen e ajrit.
- c) Të kryejë diskutime tematike për nxitjen dhe bashkërendimin e nismave konkrete në mbështetje të zbatimit të masave të përcaktuara në programin kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër.
- ç) Të rekomandojë tek institucionet politikëbërëse që lidhen me masat që duhet të merren për të përmirësuar cilësinë e ajrit.

5. Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër të mbështetet nga sekretariati teknik, rolin e të cilit e kryen struktura përgjegjëse për ajrin në ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

6. Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër të mblidhet me njoftimin e kryetarit, të paktën një herë në vit, dhe t'u raportojë ministrit përgjegjës për mjedisin dhe Kryeministrit për rezultatet e veprimtarisë së këtij Komisioni.

7. Kryetari i Komisionit Kombëtar për Ajër të Pastër, nëpërmjet sekretariatit, të organizojë mbledhjet dhe të realizojë dokumentimin e veprimtarisë së Komisionit.

8. Sekretariati teknik i Komisionit Kombëtar për Ajër të Pastër ka këto detyra:

- a) Të informojë pjesëtarët e Komisionit Kombëtar për Ajër të Pastër për takimin, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes;
  - b) Të përgatitë agjendën e takimit në përputhje me rendin e ditës;
  - c) Të mbajë minutat e takimit të cilat ua përcjell me *e-mail* për dijeni, shqyrtim dhe komente të mundshme anëtarëve të Komisionit, të cilët duhet të shprehen brenda 5 (pesë) ditëve nga data e dërgimit;
  - ç) Të konsultohet me përfaqësuesit e Komisionit, bazuar në fushën e tyre të përgjegjësisë, për çështje ose detyrime specifike që lidhen me cilësinë e ajrit në vend dhe të cilat kanë nevojë për koordinim ndërinstytucional.
9. Institucionet e përcaktuara në pikën 3, të këtij urdhri, të caktojnë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi/njoftimi i këtij urdhri, një përfaqësues të nivelit të lartë drejtues, anëtar në këtë Komision, dhe të njoftojnë ministrinë përgjegjëse për mjedisin.
  10. Në rast të ndryshimit të njw anëtari të Komisionit, institucionet të njoftojnë menjëherë ministrinë përgjegjëse për mjedisin për caktimin e anëtarit të ri.
  11. Çdo anëtar i këtij Komisioni të sigurojë dhe të mbikëqyrë zbatimin e akteve ligjore e nënligjore/masat e ndërmarra nga institucioni që ai përfaqëson, të cilat lidhen me ndotjen e cilësisë së ajrit.
  12. Ngarkohen Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër dhe institucionet e përcaktuara në pikën 3 për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDIRAMA**



NR.PROT. 3056/1  
DATE 20.6.2024

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES  
SOCIALE  
AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT  
INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK DHE  
INDUSTRIAL  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË  
TRANSPORTIT RRUGOR  
OPERATORIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT  
SHËNDETËSOR  
INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK  
INSTITUTIT TË STATISTIKAVE  
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJEN  
VENDORE  
DHOMËS SË TREGTISË DHE INDUSTRIË  
FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS

**Sekretari i Përgjithshëm**

Engjëll AGAÇI

